



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr. 06

Prishtinë, më 23. 03. 2010, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismet Beqiri – kryetar, Nerxhivane Dauti, Hajredin Hyseni,  
Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

**Pjesëmarrës:** Mimoza Ahmetaj dhe Bujar Dugolli – Deputetë të Kuvendit të Republikës  
së Kosovës.

**Mbledhjen e monitoruan:** Rrezarta Ahmeti – KDI, Lejla Selimi – OSBE, Gjita Lushi –  
Kosova sot, Donika Voca – KNN dhe Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit.

**Nga stafi Mbështetës i Komisionit:** Rrahim Demaj, koordinator dhe Visar Krasniqi,  
zyrtar ligjor.

**Mbledhjen e drejtoi: Ismet Beqiri.**

**Kryetari** konstatoi se në bazë të Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës  
së Kosovës janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

**R e n d i d i t ë s**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 09. 03. 2010,
3. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 03/P-198, i datës 16 mars 2010 dhe caktimi i datës për shqyrtimin e Peticionit të Këshillit kundër procesit gjyqësor të Albin Kurtit,
4. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës me të cilin kërkohet shqyrtimi i Programit të Qeveris së Kosovës për barazi gjinore,
5. Shqyrtimi i kërkesës së Xh. M. L. nga fshati Lugbunar i Gjakovës,
6. Caktimi i dy anëtarëve të Komisionit të cilët do t'i bashkëngjiten grupit të punës për shqyrtimin e P/L për Avokatin e Popullit,
7. Të ndryshme

## **1 Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 09. 03. 2010**

*Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e datës 09.03.2010.*

## **3. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 03/P- 198, i datës 16 mars 2010, për shqyrtimin e Peticionit të Këshillit kundër procesit gjyqësor të Albin Kurtit**

**Ismet Beqiri** - I përshëndeti deputetët e Kuvendit të Kosovës: Mimoza Ahmetaj dhe Bujar Dugollin, monitoruesit dhe mediat. Ai në vija trasha i njoftoi me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit nr. 03 – P -198, me të cilin përfundim ngarkohet Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione dhe Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, që ta shqyrtojë Peticionin e Këshillit kundër procesit gjyqësor ndaj Albin Kurtit. Dhe lidhur me këtë lejoi hapjen e debatit.

**Ibrahim Makolli** - U pajtua të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit që në rend dite të futet peticioni në njërin nga seancat e radhës. Ai në vazhdim ceku se nuk po ndërhyjmë në pushtetin gjyqësor, prandaj Kuvendi e ka për detyrë të merret me shqetësimet e qytetarëve.

**Bujar Dugolli** – Ishte i mendimit se kjo çështje ka rëndësi të veçantë, pasi i është adresuar Komisionit, prandaj si deputet kam të drejtë të marrë pjesë në mbledhje dhe nuk më shqetëson fakti që nuk jam anëtar i këtij Komisioni dhe nuk kam të drejtë vote. Ai i bëri vërejtje Kryesisë se nuk është dashur ky peticion të procedohet në Komision. U pajtua me kryetarin që Komisioni të nxjerrë rekomandim i cili duhet t'i adresohet Kryesisë së Kuvendit. Nga Komisioni, përveç të tjerash, kërkoi të formohet një komisioni hetimor *ad -hok*, i cili do të merret për ngjarjet e 10 shkurtit 2007.

**Drita Maliqi** - U pajtua me parafolësit dhe shtoi: çështja duhet të vihet në rend të ditës në seancë plenare në mënyrë që të debatohet për çështjet e ngritura.

Komisioni në mënyrë unanime u pajtua që Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës ta njoftojë për Peticionin dhe ta procedojë këtë:

### **R e k o m a n d i m**

Komisioni i rekomandon Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës që në njërin nga mbledhjet e ardhshme plenare ta marrë për shqyrtim:  
Debatin për zhvillimin e ngjarjeve të 10 shkurtit 2007.

## **4 Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, me të cilin kërkohet shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Kosovës për barazi gjinore.**

Kryetari, i njoftoi anëtarët e Komisionit me Mimoza Ahmetaj, e cila ka kërkuar të marrë pjesë në mbledhje, në të cilën do ta informojë për Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, me të cilin kërkohet shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Kosovës për barazi gjinore, prandaj e ftoi që ta marrë fjalën.

]

**Mimoza Ahmetaj** – Tha se ka kohë që flitet për punën e Programit të Agjencisë për Barazi Gjinore, që Kuvendi i Kosovës nuk e ka miratuar në mënyrë që ta detyrojë Qeverinë e Kosovë në bazë të dispozitave të Ligjit për barazi gjinore. Agjencia për Barazi Gjinore vazhdimisht merr vërejtje, gjë që në Raportin e Progresit qëndron për jetësimin e këtij programi. Këtë program nuk e kanë sjellë në Kuvend dhe kemi bërë mocion. Pra, kur ky program shndërrohet në rezolutë në Kuvend, atëherë Qeverinë e detyrojmë çdo dy vjet t’i raportojë Kuvendit për gjendjen e barazisë gjinore në institucionet e Republikës së Kosovës. Ajo i kërkoi Komisionit që Raporti dhe rekomandimet sa më parë t’i procedohen Kuvendit.

**Rrahim Demaj** – Koordinator i Komisionit i njoftoi anëtarët lidhur me Programin për barazi gjinore. Komisioni, në shtator të viti 2008, e ka pasur në shqyrtim programin dhe ka dhënë vërejtje. Gjithashtu, ua përkujtoi se Komisioni e ka mbajtur tryezën e rrumbullakët dhe ka diskutuar lidhur me atë, si dhe për Ligjin për barazi gjinore, në të cilin është kërkuar të merret nisma për plotësim dhe për ndryshim. Në fund tha se për shkak të metave procedurale nuk është proceduar programi në kuvend, e kjo e metë është nga Agjencia për Barazi Gjinore.

**Drita Maliqi** - Tha se Ligji për barazi gjinore nuk zbatohet nga Qeveria e Kosovës. Prandaj ajo vuri në pah se Programi i Qeverisë për barazi gjinore duhet të shqyrtohej, nga se kaluan dy vjet që nuk i është nënshtruar procedurave të shqyrtimit në Kuvend. Ajo ua përkujtoi prapë se e kemi për detyrë, përkundër kërkesës që ka bërë Komisioni për emërimin e drejtorit të Agjencisë për Barazi Gjinore.

Kryetari i propozoi anëtarët të cilët do të ndihmonin në shqyrtimin e programit për barazi gjinore dhe Komisioni nxori këtë:

## **P e r f u n d i m**

I. Formohet grupi i punës me këtë përbërje:

1. Shpresa Murati,
2. Drita Maliqi dhe
3. Danush Ademi

II. Grupi i punës e ka për detyrë shqyrtimin e Programit të Qeverisë për barazi gjinore dhe Komisionit t’ia paraqesë Raportin me rekomandime.

### **4. Shqyrtimi i kërkesës së Xh. M. L. nga fshati Lugbunar i Gjakovës**

**Nerxhivane Dauti** - Në cilësi të raportueses së Komisionit ia paraqiti mendimin për kërkesën e Gj. M. L. nga fshati Lugbunar i Gjakovës, i cili kërkon nga Komisioni që t’i rekomandojë Ministrisë së Transportit dhe Post – Telekomunikacionit dhe Kuvendit Komunal të Gjakovës kompensimin e parcelave të ekspropriuara për ndërtimin e

aeroportit dhe objekteve të tjera përcjellëse që i shërbejnë përdorimit të rregullt të tij për nevojat e shfrytëzuesve - Forcave Ajrore Ushtarake (KFOR – it italian)

Prandaj, Komisionit i propozon të nxjerrë këtë:

### **P ë r f u n d i m**

Komisioni i rekomandon ankuesit që t'i drejtohet me padi gjykatës kompetente për realizimin e të drejtës së kompensimit.

#### **5. Caktimi i dy anëtarëve të Komisionit, të cilët do t'i bashkëngjiten grupit të punës për shqyrtimin e P/L për Avokatin e Popullit**

Kryetari i njoftoi anëtarët me kërkesën e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, në të cilën kërkohet që këtij komisioni t'i propozohen disa anëtarë për shqyrtimin e P/L për Avokatin e Popullit

Komisioni lidhur me këtë nxori këtë:

### **P ë r f u n d i m**

Komisioni i rekomandon Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi që në grupin e punës për shqyrtimin e Projektligjit për Avokatin e Popullit të jenë:

1. Ibrahim Makolli,
2. Luljeta Shehu dhe
3. Hajredin Hyseni.

#### **6 Të ndryshme**

**Kryetari** u kërkoi Hajredin Hysenit, Nerxhivane Dautit dhe Ibrahim Makollit të përshpejtonë me amendamentet e dhëna në Projektligjin kundër dhunës në familje dhe t'i përmbahen afatit të paraparë me Rregulloren e Punës së Kuvendit

Mbledhja përfundoi në orën 14:15

Kryetari i Komisionit

-----  
Ismet Beqiri